



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

PROJEKT-VENDIM

Nr. 626 Datë 16. 01 .2026

**KRITERET PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR
PËR NDIHMËN EKONOMIKE (FONDI 6 %) PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” si dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr . 597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe VKM nr. 868 datë 29.12.2021 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr . 597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”,

PROPOZOJMË

Të miratohen kriteret e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike si më poshtë:

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar 3 muajt e fundit nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit me arsyen: Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme.
2. Për të gjitha familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas këtij fondi, duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social - ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2 të VKM nr.597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
3. Gjatë periudhës së trajtimit me fondin deri në 6 % , nëse verifikon që ka ndryshime të situatën social ekonomike, administratori shoqëror, referon familjen për të aplikuar në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike apo ndërpret periudhën e përfitimit në rast të punësimit të anëtarëve të familjes.
4. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes së masës së strukturës së familjes, për familjet përfituese të ndihmës ekonomike sipas VKM nr. 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe ndryshimeve të pësuar me VKM Nr. 868, datë 29.12.2021 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019”.

KRYETARI
Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 626/ prot.

Lezhë, më 16. 01.2026

RELACION

MBI KRITERET PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE (FONDI 6 %) PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", nenit 21, "Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror".

Që një familje të përfitoje nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike duhet të plotësojë këto kriteret të cilat duhet të miratohen në Këshillin Bashkiak çdo fillim viti, përcaktuar edhe sipas VKM nr. 597 datë 4.9.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", pika 1, "Këshilli bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmë ekonomike".

Mënyra e përfitimit të fondit 6 %, detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit në këtë proces si dhe masa e kësaj ndihme është e përcaktuar qartë përmes kriterëve të cituara në projekt-vendimin bashkëlidhur.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

